



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

RREGULLORE

PËR

KËRKESAT E TRANSPARENCËS NË LIDHJE ME INFORMACIONIN E
SHOQËRIVE TË LISTUARA

Miratuar me Vendim Bordi nr. 5, datë 26.01.2023

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi i rregullores

1. Kjo rregullore përcakton kërkesat për dhënien e informacionit periodik dhe të vazhdueshëm nga shoqëritë e listuara, titujt e të cilave janë pranuar për tregtim në një treg të rregulluar në Republikën e Shqipërisë.
2. Kjo rregullore përcakton:
 - a. mënyrën dhe formën e dhënies së informacionit nga shoqëritë e listuara, për të siguruar transparencën e duhur, përmes informacionit të rregulluar,
 - b. afatet për publikimin e informacionit, dhe
 - c. formën dhe përmbajtjen e raporteve vjetore të shoqërive të listuara.
3. Kërkesat e kësaj rregulloreje janë të zbatueshme për të gjithë emetuesit, titujt e të cilëve janë pranuar për tregtim në një treg të rregulluar në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2 **Baza ligjore**

Kjo rregullore është hartuar në bazë dhe për zbatim të nenit 7, pika 2, germa gj, neni 295, pika 3, neni 300 dhe 301 të Ligjit nr. 62/2020, datë 14.5.2020, "Për Tregjet e Kapitalit", këtej e tutje përmendur si 'Ligji'.

Neni 3 **Objekti i zbatimit**

Kjo rregullore zbatohet nga shoqëritë e listuara, përkufizuar në nenin 3, pika 53 të Ligjit, të cilat kanë detyrimin të japin informacion sipas nenit 300 e në vijim të Ligjit.

Neni 4 **Përkufizime**

Të gjitha përkufizimet e dhëna këtu kanë të njëjtin kuptim me ato të Ligjit.

Neni 5 **Lloji i informacionit që bëhet publik**

Shoqëritë e listuara bëjnë publike informacionet si më poshtë:

1. Raportet financiare vjetore, në mënyrë të vazhdueshme, në përputhje me nenin 302 të Ligjit, si dhe raportet financiare gjashtëmujore dhe raportet e ndërmjetme të administratorit/ve, në përputhje me këtë Rregullore;
2. Informacione që kanë ndikim mbi çmimet, në përputhje me nenin 300 dhe 303 të Ligjit, si dhe që përfshijnë dhe janë subjekt i kësaj Rregulloreje, si më poshtë:
 - (a) informacione rreth pjesëmarrjeve të rëndësishme në kapital, në përputhje me nenet 12 deri në 14 të kësaj Rregulloreje,
 - (b) informacione për mbajtësit e titujve të pranuar për tregtim në një treg të rregulluar të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me nenet 15 dhe 16 të kësaj Rregulloreje,
 - (c) informacione të privileguara, në përputhje me nenin 17 të kësaj Rregulloreje dhe Rregullores "Për abuzimin me tregun",
 - (d) informacione mbi transaksionet e drejtuesve, në përputhje me nenin 18 të kësaj Rregulloreje dhe Rregullores "Për abuzimin me tregun".
3. Informacioni i përcaktuar nga bursa, në përputhje me nenin 295, pika 1 të Ligjit, për të mbrojtur investitorin dhe për funksionimin efektiv të tregut, që bëhet publik kur kërkohet nga bursa, në përputhje me nenin 295, pika 3 të Ligjit.

KREU II

INFORMACIONI PERIODIK

Neni 6

Raportet financiare vjetore

1. Emetuesi publikon raportin financiar vjetor jo më vonë se 4 [katër] muaj nga mbyllja e çdo viti financiar dhe sigurohet që ai të jetë i disponueshëm publikisht për të paktën 10 [dhjetë] vjet.
2. Emetuesi, jo më vonë se 4 [katër] muaj pas mbylljes së vitit financiar dhe përpara datës në të cilën raporti financiar vjetor i vihet në dispozicion për herë të parë publikut, boton një njoftim në të paktën një gazetë kombëtare të Republikës së Shqipërisë, ku deklaron se në çfarë date dhe në cilën adresë interneti do të jetë i vlefshëm publikisht raporti i përmendur në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni, përveç disponueshmërisë së tyre në Regjistrin e Shoqërive Tregtare.
3. Emetuesi bën me dije Autoritetin për njoftimin dhe i dorëzon raportin vjetor financiar në Dokument me Format të Transferueshëm (PDF) në të njëjtën kohë me publikimin e tij, sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni dhe e përcjell pa vonesë, por jo përpara publikimit, në Regjistrin e Shoqërive Tregtare.
4. Përveç parashikimeve të nenit 302 të Ligjit, raporti financiar vjetor përfshin:
 - (a) pasqyrat financiare të audituara;
 - (b) raportin e administratorit/ve, dhe
 - (c) deklaratat e dhëna nga personat përgjegjës të emetuesit, ku jepen qartë emrat dhe funksionet e tyre, në mënyrë që, për aq sa kanë dijeni, pasqyrat e përgatitura financiare të përgatitura në përputhje me grupin e standardeve të zbatueshme të kontabilitetit të paraqesin një panoramë të vërtetë dhe të drejtë të aktiveve, pasiveve, pozicionit financiar dhe fitimit dhe humbjes së emetuesit dhe shoqërive që janë pjesë e pasqyrave financiare të konsoliduara, të marra si një e tërë dhe që raporti i administratorit përmban një pasqyrë të drejtë të zhvillimit dhe performancës së biznesit dhe pozicionit të emetuesit dhe shoqërive që janë pjesë e pasqyrave financiare të konsoliduara, të marra si një e tërë, së bashku me përshkrimin e rreziqeve dhe pasigurive kryesore me të cilat përballen.
5. Në përputhje me Shtojcën I, pasqyrat financiare përfshijnë:
 - (a) pasqyrën e pozicionit financiar (bilanci),
 - (b) pasqyrën e fitimit dhe humbjes,
 - (c) raport mbi të ardhurat e tjera gjithpërfshirëse,
 - (d) pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare,
 - (e) pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe

- (f) shënimet e pasqyrave financiare.
6. Pasqyrat financiare auditohen nga audituesit ligjorë të caktuar nga emetuesi. Raporti i auditimit, i nënshkruar nga personi ose personat përgjegjës për auditimin e pasqyrave financiare, bëhet tërësisht publik, së bashku me raportin financiar vjetor.
7. Raporti i administratorit/ve është në përputhje me informacionin e përcaktuar në nenin 302, pika 2 të Ligjit dhe përmban të paktën një panoramë të drejtë të zhvillimeve të aktivitetit të shoqërisë dhe pozicionit të saj dhe jep të dhëna bashkë me një përshkrim të rreziqeve dhe pasigurive kryesore me të cilat përballlet. Raporti i administratorit/ve përmban të dhëna për:
- (a) zhvillimin e mundshëm të emetuesit në të ardhmen,
 - (b) veprimtaritë në fushën e kërkimit dhe zhvillimit,
 - (c) informacionet lidhur me blerjen e aksioneve të veta,
 - (d) ekzistencën e degëve të emetuesit dhe
 - (e) përdorimin e instrumenteve financiare nga ana e emetuesit dhe kur është e rëndësishme për vlerësimin e aktiveve, pasiveve, pozicionit financiar, fitimit ose humbjes:
 - (i) objektivat dhe politikat e menaxhimit të rrezikut financiar të emetuesit, përfshi politikën e tij për mbrojtjen e çdo lloji transaksioni të rëndësishëm të parashikuar, për të cilat përdoren metoda mbrojtëse kontabël dhe
 - (ii) ekspozimin e emetuesit ndaj rrezikut të çmimeve, rrezikut të kreditimit, rrezikut të likuiditetit dhe rrezikut të fluksit të mjeteve monetare.

Neni 7

Raportet financiare gjashtëmujore

1. Emetuesi i aksioneve ose titujve të borxhit publikon një raport gjashtëmujor, që mbulon aktivitetin e gjashtëmujorit të parë të vitit ushtrimor, brenda 2[dy] muajve nga përfundimi i periudhës. Emetuesi sigurohet që raporti gjashtëmujor të mbetet në dispozicion të publikut për të paktën 10 [dhjetë] vjet.
2. Emetuesi, jo më vonë se 3 [tre] muaj pas përfundimit të periudhës së raportimit dhe përpara datës kur raporti financiar gjashtëmujor i është vënë në dispozicion publikut për herë të parë dhe për çdo vit financiar, emetuesi duhet të botojë një njoftim të paktën në një gazetë kombëtare të Republikës së Shqipërisë, ku jepet data dhe adresa e internetit në të cilën raporti do të jetë publik, përveç disponueshmërisë në Regjistrin e Shoqërive Tregtare.
3. Emetuesi ve në dijeni Autoritetin për njoftimin dhe i dorëzon raportin financiar gjashtëmujor në Dokument me Format të Transferueshëm (PDF) në të njëjtën kohë me publikimin e tij, sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni dhe e përcjell pa vonesë raportin financiar gjashtëmujor, por jo përpara botimit të njoftimit, për t'u ruajtur në Regjistrin e Shoqërive Tregtare.

4. Raporti gjashtëmujor financiar përfshin:
 - (a) pasqyrat e përmbledhura financiare,
 - (b) raportin e ndërmjetëm të administratorit/ve dhe
 - (c) deklaratat e dhëna nga personat përgjegjës të emetuesit, ku jepen qartë emrat dhe funksionet e tyre, në mënyrë që, për aq sa janë në dijeni, grupi i pasqyrave të përmbledhura financiare të hartuara në përputhje me standardet përkatëse të kontabilitetit, të paraqesin një panoramë të vërtetë dhe të drejtë të aktiveve, pasiveve, pozicionit financiar dhe fitimeve ose humbjeve të emetuesit dhe të shoqërive të përfshira në këtë përmbledhje të konsoliduar në tërësi dhe që raporti i ndërmjetëm i menaxhimit të përmbajë një pasqyrë të drejtë të informacionit që kërkohet sipas paragrafit (4) të këtij neni.
5. Pasqyrat e përmbledhura financiare duhet të përmbajë të paktën një përmbledhje të bilancit, një pasqyrë të përmbledhur të fitimit dhe humbjeve dhe shënimet shpjeguese të këtyre pasqyrave. Për përgatitjen e bilancit dhe pasqyrës të fitimit dhe humbjeve, emetuesi zbaton të njëjtat parime identifikimi dhe matjeje si ato për raportet financiare vjetore.
6. Raporti i ndërmjetëm i administratorit/ve përfshin të paktën një përshkrim të ngjarjeve të rëndësishme që kanë ndodhur gjatë gjashtë muajve të parë të vitit ushtrimor dhe ndikimin e tyre në pasqyrat e përmbledhura financiare, së bashku me përshkrimin e rreziqeve dhe pasigurive kryesore për gjashtë muajt e mbetur të vitit ushtrimor, në përputhje me Shtojcën II të kësaj Rregulloreje. Për emetuesit e aksioneve, raporti i ndërmjetëm i administratorit/ve përfshin edhe transaksionet kryesore të palëve të lidhura.
7. Për raportin gjashtëmujor, emetuesi përdor formatin standard sipas Shtojcës I të kësaj Rregulloreje.
8. Nëse raporti financiar gjashtëmujor është audituar, raporti i auditimit do të paraqitet i plotë. E njëjta gjë vlen edhe në rastin e kontrollit nga audituesit. Në rast se raporti financiar gjashtëmujor nuk është audituar apo kontrolluar nga audituesit, emetuesi bën një deklaratë për këtë qëllim në raportin e tij.

Neni 8

Raportet financiare tremujore

Emetuesit, aksionet e të cilit janë pranuar për tregtim në një treg të rregulluar, mund të publikojnë me nismën e tyre raporte financiare tremujore.

Neni 9

Përgjegjësitë dhe detyrimet

Përgjegjësia për hartimin e informacionit dhe publikimin e tij sipas neneve 6 deri në 8 të kësaj Rregulloreje u ngarkohet organeve administrative, drejtuese ose mbikëqyrëse të emetuesit.

Neni 10 Përjashtime

Nenet 6 deri në 9 të kësaj Rregulloreje nuk gjejnë zbatim për një emetues që emeton vetëm tituj borxhi të pranuar për tregtim në një treg të rregulluar, vlera për njësi e të cilave është të paktën 6 000 000 lekë ose, në rastin e titujve të borxhit të shprehur në monedhë të ndryshme nga leku, që, në datën e emetimit, kanë vlerë për njësi me shumë të barasvlershme me të paktën 6 000 000 lekë.

KREU III INFORMIMI I VAZHDUESHËM

PJESA 1 – Informacion për pjesëmarrjet e rëndësishme në kapital

Neni 11

Njoftimi i blerjes ose shitjes së pjesëmarrjeve të rëndësishme në kapital

1. Aksionari, i cili blen ose shet aksionet e emetuesit, aksionet e të cilit janë pranuar për tregtim në një treg të rregulluar dhe me të cilat lidhen të drejtat e votimit, njofton menjëherë emetuesin për pjesën e të drejtave të votës të emetuesit që zotërohen nga aksionari si rezultat i blerjes ose shitjes, kur kjo pjesë arrin, tejkalon ose është nën kufirin prej 10%, 20%, 30%, 50% dhe 75%.
2. Emetuesi, aksionet e të cilit janë pranuar për t'u tregtuar në një treg të rregulluar, i cili blen ose shet aksionet e veta, qoftë vetë apo përmes një personi që vepron në emrin e tij, por për llogari të emetuesit, bën publike pjesën e aksioneve të veta sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 4 [katër] ditë tregtimi pas kësaj blerjeje ose shitjeje, kur kjo pjesë arrin, tejkalon ose është nën kufirin prej 10% të të drejtave të votimit.
3. Të drejta e votimit llogariten mbi bazën e të gjitha aksioneve me të cilat lidhen të drejtat e votës, edhe nëse ushtrimi i tyre është pezulluar. Për më tepër, ky informacion jepet edhe lidhur me të gjitha aksionet që janë në të njëjtën klasë dhe me të cilat lidhen të drejtat e votimit. Për qëllimin e përlogaritjes së kufijve të parashikuar në këtë nen, emetuesi bën publik numrin e përgjithshëm të të drejtave të votimit dhe të kapitalit në fund të çdo muaji kalendarik, gjatë të cilit shënohet një ulje apo rritje e këtij numri të përgjithshëm.
4. Aksionari njofton emetuesin rreth pjesës së të drejtave të votimit, kur kjo pjesë arrin, tejkalon ose është nën kufijtë e parashikuar në paragrafin (1) të këtij neni, si rezultat i ngjarjeve që ndryshojnë konfigurimin e të drejtave të votimit. Në rast se vendi i themelimit të emetuesit është jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, njoftimi bëhet për ngjarje të barasvlershme.
5. Ky nen nuk gjen zbatim për aksionet e blera vetëm me qëllimin e klerimit dhe shlyerjes brenda ciklit të shkurtër të zakonshëm të shlyerjes ose për kujdestarët që zotërojnë aksione në cilësinë e tyre të kujdestarit, me kusht që këta kujdestarë të ushtrojnë vetëm të drejtat e votimit që janë të lidhura me këto aksione, sipas udhëzimeve të dhëna me shkrim ose me anë të mjeteve elektronike.

6. Ky nen nuk gjen zbatim për blerjen ose shitjen e pjesëmarrjeve të rëndësishme në kapital që arrijnë ose tejkalojnë kufirin prej 10 nga një krijues tregu, që vepron në cilësinë e tij si krijues tregu, me kusht që të mos ndërhyjë as në administrimin e emetuesit të interesuar, as të ushtrojë ndikim mbi emetuesin për blerjen e këtyre aksioneve ose për uljen e çmimit të aksioneve.

Neni 12

Blerja ose shitja e pjesëve të rëndësishme të të drejtave të votimit

1. Kërkesat për njoftim të parashikuara në nenin 11, pika 1 të kësaj Rregulloreje gjejnë zbatim edhe për personin fizik ose juridik, për aq kohë sa ka të drejtë të blejë, të shesë ose të ushtrojë të drejtat e votimit në çdo njërin prej rasteve të mëposhtme apo një kombinim të tyre:
- (a) të drejtat e votimit që zotërohen nga një person i tretë me të cilin ky person ose subjekt ka lidhur një marrëveshje, e cila i detyron të miratojnë, me anë të ushtrimit të përbashkët të të drejtave të votimit që zotërojnë, një politikë të përbashkët që zgjat në kohë për drejtimin e emetuesit në fjalë,
 - (b) të drejtat e votimit nga një person i tretë, në bazë të një marrëveshjeje të lidhur me atë person ose subjekt, që parashikon transferimin e përkohshëm për marrjen në konsideratë të të drejtave të votimit në fjalë,
 - (c) të drejtat e votimit që lidhen me aksionet, të cilat i janë dhënë këtij personi ose subjekti si kolateral, me kusht që personi ose subjekti të kontrollojë të drejtat e votimit dhe të deklarojë qëllimin që ka për ushtrimin e tyre,
 - (d) të drejtat e votimit që lidhen me aksionet në të cilat personi ose subjekti ka interes gjatë jetës,
 - (e) të drejtat e votimit që zotërohen ose mund të ushtrohen në kuptim të pikave (a) deri në (d) nga shoqëria që kontrollon ky person ose subjekt,
 - (f) të drejtat e votimit që lidhen me aksionet e depozituara te ky person ose subjekt, të cilat personi ose subjekti mund t'i ushtrojë sipas gjykimit të tij, në mungesë të udhëzimeve konkrete nga aksionarët,
 - (g) të drejtat e votimit që zotërohen nga një person i tretë në emrin e vet ose për llogari të këtij personi ose subjekti,
 - (h) të drejtat e votimit që personi ose subjekti mund t'i ushtrojë si përfaqësues, kur personi ose subjekti mund t'i ushtrojë të drejtat e votimit sipas gjykimit të tij, në mungesë të udhëzimeve konkrete nga aksionarët.
2. Kriteret e njoftimit, të parashikuara në nenin 11, pika 1 të kësaj Rregulloreje, gjejnë zbatim për personin fizik ose juridik, i cili zotëron në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë instrumente financiare që sjellin si rezultat të drejtën e blerjes, vetëm me nismën e këtij mbajtësi, sipas një marrëveshjeje zyrtare, të aksioneve me të drejta votimi të lidhura me to, të emetuara tashmë, të emetuesi aksionet e të cilit janë pranuar për tregtim në një treg të rregulluar. Kjo vlen edhe për aksionet që kanë efekt të krahasueshëm

ekonomik me instrumentet e përmendura në këtë paragraf, pavarësisht nëse ofrojnë ose jo të drejtën për dorëzim fizik.

Neni 13

Procedurat e njoftimit dhe dhënies së informacionit mbi pjesëmarrjet e rëndësishme në kapital

1. Njoftimi i parashikuar në nenet 11 dhe 12 të kësaj Rregulloreje përfshin të dhënat e mëposhtme:
 - (a) gjendjen në lidhje me të drejtat e votimit,
 - (b) zinxhiri i ndërmarrjeve të kontrolluara përmes të cilave zotërohen efektivisht të drejtat e votimit, kur ka,
 - (c) datën kur është arritur ose tejkalluar kufiri dhe
 - (d) identitetin e aksionarit, edhe nëse aksionari nuk ka të drejtë të ushtrisë të drejtat e votimit, sipas parashikimeve të përcaktuara në nenin 12 të kësaj Rregulloreje, si dhe të personit fizik ose juridik që ka të drejtë të ushtrisë të drejtat e votimit për llogari të këtij aksionari.
2. Emetuesi njoftohet menjëherë, por jo më vonë sesa 4 [katër] ditë tregtimi, llogaritja e të cilave nis të nesërmen e datës në të cilën aksionari ose personi fizik apo juridik i përmendur në nenin 13 të kësaj Rregulloreje:
 - (a) merr dijeni për blerjen ose shitjen apo për mundësinë e ushtrimit të të drejtave të votimit, ose për të cilat duhej të kishte marrë dijeni, duke pasur parasysh rrethanat, pavarësisht datës në të cilën hyn në fuqi blerja, shitja ose mundësia e ushtrimit të të drejtave të votimit ose
 - (b) merr njoftim për ngjarjen e përmendur në nenin 11, pika 4 të kësaj Rregulloreje.
3. Shoqëria tregtare përjashtohet nga kryerja e njoftimit të nevojshëm sipas paragrafit (1) të këtij neni, nëse njoftimi bëhet nga shoqëria mëmë ose, kur vetë shoqëria mëmë është shoqëri e kontrolluar, nga shoqëria e saj mëmë.
4. Pas marrjes së njoftimit të parashikuar në paragrafin (1) të këtij neni, por jo më vonë sesa 3 [tre] ditë tregtimi, emetuesi njofton Autoritetin dhe bën publik të gjithë informacionin që përmban njoftimi.
5. Për njoftimin e parashikuar në paragrafin (1), aksionari përdor formatin standard sipas Shtojcës III të kësaj Rregulloreje.

Neni 14

Informacione shtesë

1. Emetuesi i aksioneve të pranuar për tregtim në një treg të rregulluar bën publik pa vonesë çdo ndryshim në të drejtat që lidhen me klasat të ndryshme të aksioneve, duke

përfshirë ndryshimet në të drejtat që lidhen me titujt derivativë të emetuar nga vetë emetuesi dhe duke siguruar qasje në të drejtat e këtij emetuesi.

2. Emetuesi i titujve të tjerë përveç aksioneve të pranuar për tregtim në një treg të rregulluar bën publik pa vonesë çdo ndryshim në të drejtat e mbajtësit të titujve të tjerë përveç aksioneve, duke përfshirë ndryshimet në kushtet dhe kriteret e këtyre titujve, që mund të ndikojnë në mënyrë të tërthortë te këto të drejta, që lindin posaçërisht nga ndryshimi i kushteve të huasë ose i normave të interesit.
3. Emetuesi i titujve të pranuar për tregtim në një treg të rregulluar bën publike pa vonesë elementet e huasë së re dhe, sidomos, çdo garanci apo titull lidhur me të. Ky paragraf nuk gjen zbatim për organizmat publikë ndërkombëtarë në të cilat Republika e Shqipërisë është anëtare.

PJESA 2 – Informacioni për mbajtësit e titujve të pranuar për tregtim në një treg të rregulluar

Neni 15

Kërkesat për informacion nga emetuesit aksionet e të cilëve janë pranuar për tregtim në një treg të rregulluar

1. Emetuesi i aksioneve të pranuar për tregtim në një treg të rregulluar siguron trajtim të barabartë për të gjithë mbajtësit e aksioneve që kanë të njëjtin pozicion.
2. Emetuesi siguron vënien në dispozicion të të gjitha mjeteve dhe informacioneve të nevojshme që lejojnë mbajtësit e aksioneve të ushtrojnë të drejtat e tyre dhe ruajtjen e paprekshmërisë së të dhënave. Aksionarët nuk ndalohen të ushtrojnë të drejtat e tyre përmes përfaqësimit. Veçanërisht, emetuesi:
 - (a) informon mbi vendin, orën dhe programin e mbledhjeve, numrin e përgjithshëm të aksioneve dhe të drejtave të votimit, si dhe të drejtat e mbajtësve për të marrë pjesë në mbledhje,
 - (b) vë në dispozicion një formular përfaqësimi, në letër ose, kur është rasti, përmes mjeteve elektronike, për çdo person me të drejtë vote në Asamblenë e Aksionarëve, së bashku me njoftimin për mbledhjen ose, kur kërkohet, pas shpalljes së mbledhjes,
 - (c) cakton si agjent një institucion financiar përmes të cilit aksionarët mund të ushtrojnë të drejtat e tyre financiare dhe
 - (d) publikon njoftime ose shpërndan informacion lidhur me ndarjen dhe pagesën e dividendëve dhe emetimin e aksioneve të reja, përfshi informacion për rregullat e caktimit të pjesës, nënshkrimin, anulimin ose konvertimin.
3. Për qëllimin e përcjelljes së informacionit të aksionarët, emetuesi mund të përdorë mjete elektronike, me kusht që vendimi të merret në Asamblenë e Përgjithshme dhe të përmbushë të paktën kriteret në vijim:

- (a) përdorimi i mjeteve elektronike nuk varet në asnjë mënyrë nga vendndodhja e selisë ose vendqëndrimit të aksionarit ose, në rastet e parashikuara në nenin 12, paragrafi (1), shkronja (a) deri në (h), të kësaj Rregulloreje, të personave fizikë ose juridikë,
- (b) miratohen rregulla identifikimi, në mënyrë që aksionarët ose personat fizikë apo juridikë me të drejtë ushtrimi apo drejtimi të ushtrimit të të drejtave të votës të informohen efektivisht,
- (c) aksionarët ose, në rastet e parashikuara në nenin 12, paragrafi (1), germa (a) deri në (e), të kësaj Rregulloreje, personat fizikë apo juridikë që kanë të drejtën e blerjes, shitjes apo ushtrimit të të drejtave të votës, kontaktohen me shkrim për t'iu kërkuar miratimin për përdorimin e mjeteve elektronike për përvjeljen e informacionit dhe, në rast se ata nuk kundërshtojnë brenda një afati të arsyeshëm, por jo më të gjatë se [2 javë], miratimi i tyre konsiderohet i dhënë. Ata mund të kërkojnë në çdo kohë në të ardhmen që informacioni t'u përcillet me shkrim dhe
- (d) çdo shpërndarje e kostos që përfshin përcjellja e këtij informacioni me anë të mjeteve elektronike përcaktohet nga emetuesi në përputhje me parimin e trajtimit të barabartë, parashikuar në paragrafin (1) të këtij neni.

Neni 16

Kriteret e informacionit për emetuesit titujt e borxhit të të cilëve pranohen për tregtim në një treg të rregulluar

1. Emetuesi i titujve të borxhit të pranuar për tregtim në një treg të rregulluar sigurohet që të gjithë mbajtësit e titujve të borxhit me renditje *pari passu* marrin trajtim të barabartë sa u takon të drejtave që lidhen me këta tituj borxhi.
2. Emetuesi sigurohet që të gjitha mjetet dhe informacioni, të nevojshme për t'iu mundësuar mbajtësve të titujve të borxhit të ushtrojnë të drejtat e tyre, janë të vlefshme publikisht dhe se do të ruhet paprekshmëria e të dhënave. Mbajtësit e titujve të borxhit nuk ndalohen të ushtrojnë të drejtat e tyre përmes përfaqësimit. Veçanërisht, emetuesi:
 - (a) publikon njoftimet ose shpërndan informacion lidhur me vendin, orën dhe programin e mbledhjeve të mbajtësve të titujve të borxhit, pagesën e interesit, kryerjen e konvertimeve, të drejtat e nënshkrimit ose anulimit dhe shlyerjen, si dhe të drejtën e këtyre mbajtësve për të marrë pjesë në to,
 - (b) vendos në dispozicion formularin e përfaqësimit në letër ose, kur është e mundur, me anë të mjeteve elektronike, për çdo person me të drejtë vote në mbledhjen e mbajtësve të titujve të borxhit, së bashku me njoftimin për mbledhjen ose, kur kërkohet, pas njoftimit të mbledhjes dhe
 - (c) cakton si agjent një institucion financiar përmes të cilit mbajtësit e titujve të borxhit mund të ushtrojnë të drejtat e tyre financiare.
3. Për qëllime të përcjelljes së informacionit të mbajtësve të titujve të borxhit, emetuesit mund të përdorin mjete elektronike, me kusht që vendimi për këtë të merret nga Asambleja e Përgjithshme dhe të përmbush kriteret në vijim:

- (a) përdorimi i mjeteve elektronike nuk varet në asnjë mënyrë nga vendndodhja e selisë ose vendqëndrimi të mbajtësit të titujve të borxhit apo të ndërmjetësit që përfaqëson këtë mbajtës,
- (b) do të miratohen rregulla identifikimi, në mënyrë që mbajtësit e titujve të borxhit të informohen efektivisht,
- (c) mbajtësit e titujve të borxhit kontaktohen me shkrim për të kërkuar miratimin e tyre për përdorimin e mjeteve elektronike të përcjelljes së informacionit dhe, në rast se nuk paraqesin kundërshtim brenda një afati të arsyeshëm, miratimi i tyre do të konsiderohet i dhënë. Ata kanë mundësi të kërkojnë në çdo kohë në të ardhmen që informacioni të përcillet me shkrim, dhe
- (d) ndarjet e kostove që përfshin përcjellja e informacionit përmes mjeteve elektronike do të përcaktohen nga emetuesi në përputhje me parimin e trajtimit të barabartë, parashikuar në paragrafin (1) të këtij neni.

PJESA 3 – Informacioni i brendshëm dhe transaksionet e drejtuesve

Neni 17

Bërja publike e informacionit të privilegjuar

1. Emetuesi bën publik sa më shpejt të jetë e mundur informacionin e privilegjuar, që lidhet drejtpërdrejt me emetuesin në përputhje me parashikimet e nenit 352, pika 1 të Ligjit.
2. Informacioni i privilegjuar bëhet publik në përputhje me Rregulloren “Për abuzimin me tregun”.

Neni 18

Transaksionet e drejtuesve

1. Personat e ngarkuar me përgjegjësi drejtuese, si dhe personat e lidhur ngushtë me ta njoftojnë emetuesin dhe Autoritetin në raport me emetuesit, për çdo transaksion të kryer në llogarinë e vet që përfshin aksionet ose instrumentet e borxhit të emetuesit ose derivativë apo instrumente të tjera financiare të lidhura me to.
2. Njoftimet lidhur me transaksionet bëhen në përputhje me Rregulloren “Për abuzimin me tregun”.

PJESA 4 – Detyrime të përgjithshme

Neni 19

Gjuhët

1. Kur emetuesi i titujve e ka vendndodhjen në Republikën e Shqipërisë, çdo informacion mbështetur në këtë Rregullore jepet në gjuhën shqipe.

2. Kur emetuesi i titujve e ka vendndodhjen jashtë Republikës së Shqipërisë, çdo informacion në mbështetje të kësaj Rregulloreje jepet në gjuhën shqipe.
3. Kur titujt pranohen për tregtim në një treg të rregulluar pa miratimin e emetuesit, detyrimi i parashikuar në paragrafin (1) dhe paragrafin (2) të këtij neni nuk i takon emetuesit, por personit që ka kërkuar pranimin pa miratimin e emetuesit.
4. Si përjashtim nga paragrafi (1) i këtij neni, kur titujt që kanë vlerë për njësi me të paktën 6 000 000 lekë ose në rastin e titujve të borxhit të shprehur në monedhë të ndryshme nga leku që kanë vlerë për njësi të barasvlershme me të paktën 6 000 000 lekë në datën e emetimit dhe pranohen për tregtim në një treg të rregulluar, informacioni i rregulluar i jepet publikut ose në gjuhën e parashikuar në paragrafin (1) të këtij neni ose në një gjuhë që përdoret zakonisht në fushën e financës ndërkombëtare, që e zgjedh emetuesi ose personi i cili, pa miratimin e emetuesit, ka kërkuar pranimin.

Neni 20

Shpërndarja dhe hyrja në informacionin e rregulluar dhe bazën qendrore të të dhënave

1. Shpërndarja e informacionit të rregulluar bëhet me anë të mjeteve teknike që sigurojnë mundësinë e hyrjes, të leximit dhe mirëmbajtjen në një medium të qëndrueshëm informacioni.
2. Emetuesi, ose personi që ka paraqitur kërkesë për t'u pranuar për të tregtuar në një treg të rregulluar pa miratimin e emetuesit, ofron informacion të rregulluar në mënyrë të tillë që të sigurojë marrjen e shpejtë dhe jodiskriminuese të këtij informacioni dhe e vendos në dispozicion të mekanizmit të përmendur në paragrafin (4) të këtij neni.
3. Emetuesi, ose personi që ka paraqitur kërkesë për t'u pranuar për të tregtuar në një treg të rregulluar pa miratimin e emetuesit, nuk mund t'u vendosë asnjë kosto të posaçme investitorëve për ofrimin e këtij informacioni. Emetuesi përdor mediat te të cilat mund të mbështetet në mënyrë të arsyeshme për shpërndarjen efektive të informacionit te publiku në Republikën e Shqipërisë. Sidoqoftë, nuk është detyrim përdorimi vetëm i atyre mediave, operatorët e të cilëve janë të vendosur në territorin e Republikës së Shqipërisë.
4. Informacioni i rregulluar fillimisht do të ruhet në nivel qendror në Regjistrin e Shoqërive Tregtare, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Autoriteti mund të caktojë një mekanizëm zyrtar për ruajtjen qendrore të informacionit të rregulluar. Ky mekanizëm duhet të jenë në përputhje me standardet minimale për cilësinë e sigurisë, besueshmërinë e burimit të informacionit, kohën e regjistrimit dhe lehtësinë në akses nga përdoruesit përfundimtarë.

Neni 21

Forma dhe afatet e informacionit

1. Emetuesi bën menjëherë publik informacionin sipas nenit 5, pika 3 të kësaj Rregulloreje.
2. Emetuesi përdor formatin standard, sipas Shtojcës IV të kësaj Rregulloreje.

PJESA 5 – Emetuesit e vendosur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë

Neni 22

Dispozita për emetuesit me seli jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë

1. Kur emetuesi e ka selinë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, Autoriteti mund ta përjashtojë emetuesin nga kërkesat e neneve 6 deri në 9, nenit 11, pika 2 dhe 3, nenit 13, pika 4 dhe nenit 14 deri në 16 të kësaj Rregulloreje, me kusht që ligji i vendit të selisë në fjalë të përcaktojë kërkesa të barasvlershme. Megjithatë, informacioni i parashikuar nga kërkesat e përcaktuara në legjislacionin e vendit të selisë së emetuesit paraqitet në përputhje me nenin 19 dhe deklarohet në përputhje me nenin 20 të kësaj Rregulloreje.
2. Emetuesi me seli jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë do të konsiderohet se vendos kërkesa ekuivalente me ato të përcaktuara në nenin 6, pika 4/b të kësaj Rregulloreje ku, sipas ligjit të atij vendi, raporti vjetor i administratorit kërkohet të përfshijë informacionin si vijon:
 - a) një përshkrim i drejtë i zhvillimit dhe performancës së biznesit të emetuesit dhe pozicionit të tij, së bashku me një përshkrim të rreziqeve dhe pasigurive kryesore me të cilat përballet, të tilla që ky përshkrim të paraqesë një analizë të balancuar dhe gjithëpërfshirëse të zhvillimit dhe performancës së biznesit të emetuesit dhe të pozicionit të tij, në përputhje me madhësinë dhe kompleksitetin e biznesit;
 - b) një tregues i çdo ngjarjeje të rëndësishme që ka ndodhur që nga fundi i vitit financiar;
 - c) tregues të zhvillimit të mundshëm të emetuesit në të ardhmen. Analiza e përmendur në pikën (a) të këtij paragrafi, për aq sa është e nevojshme për të kuptuar zhvillimin, performancën ose pozicionin e emetuesit, duhet të përfshijë treguesit kryesorë të performancës financiare dhe sipas rastit, treguesit jofinanciarë të lidhura me biznesin e caktuar.
3. Emetuesi me seli jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë do të konsiderohet se vendos kërkesat ekuivalente me ato të përcaktuara në nenin 7, pika 6 të kësaj Rregulloreje ku, sipas ligjit të atij vendi, kërkohet që përveç pasqyrave të përmbledhura financiare, raporti i ndërmjetëm i administratorit të përfshijë të paktën informacionin e mëposhtëm:
 - a) përshkrim i periudhës së mbuluar;
 - b) treguesit mbi zhvillimet e pritshme për 6 muajt e mbetur të vitit financiar;
 - c) për emetuesit e aksioneve dhe nëse nuk janë zbuluar tashmë në mënyrë të vazhdueshme, transaksionet e palëve kryesore të lidhura.

KREU IV
MASAT ADMINISTRATIVE

Neni 23

Urdhri për riauditim

1. Autoriteti, në çdo kohë, nëse vlerëson nevojën e kryerjes së një riauditimi të pasqyrave financiare, nxjerr urdhër për riauditim.
2. Për kryerjen e auditimit, Autoriteti cakton një auditues ligjor.

Neni 24

Rezultatet e riauditimit

1. Nëse nga riauditimi i pasqyrave financiare konstatohen pasaktësi apo gabime, Autoriteti mund të urdhërojë shoqërinë e listuar të publikojë gabimin dhe korrigjimin e tij.
2. Autoriteti në rast se vlerëson se publikimi mund të dëmtojë interesat e shoqërisë së listuar, urdhëron korrigjimin, por nuk nxjerr urdhër për publikim.
3. Publikimi, sipas pikës 1 të këtij neni, bëhet pa vonesë, mbështetur në nenin 20, pika 3 të kësaj Rregulloreje.

Neni 25
Njoftimi i organeve të tjera

Autoriteti i raporton faktet, që ngrenë dyshime për elementë të ndonjë veprë penale në lidhje me raportimin financiar të një shoqërie të listuar, autoritetit përgjegjës për ndjekjen penale. Ai mund të përcjellë të dhëna personale për personat përkatës ndaj të cilëve ngrihet dyshimi ose të cilët mund të konsiderohen si dëshmitarë.

Neni 26
Ushtrimi i kompetencave mbikëqyrëse dhe kompetencave për masat administrative

Gjatë vendosjes së masës administrative, Autoriteti merr parasysh të gjitha rrethanat përkatëse dhe sigurohet që masa administrative të jetë efektive dhe parandaluese, si dhe në proporcionalitet me shkallën e pasojave.

KREU V
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 27
Hyrja në fuqi dhe zbatimi

Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë.

SHTOJCA I – FORMATI STANDARD PËR RAPORTET FINANCIARE VJETORE DHE GJASHTËMUJORE

[Të dhënat identifikuese të emetuesit, përfshi Numrin Identifikues të Personit Juridik (NIPT)]

[Raportet financiare të 6-mujorit hartohen në mënyrë të përmbledhur. Bilanci i përmbledhur dhe pasqyra e përmbledhur e fitimit dhe humbjes përmban zërat kryesorë (nëntotalet dhe totalet e nënvijëzuara me ngjyrë të zezë në këtë format).

Emetuesi mund të përfshijë zëra shtesë nëse, si rezultat i mungesës së tyre, pasqyrat financiare gjashtëmujore do të jepnin një pamje jo të drejtë të aktiveve, detyrimeve, pozicionit financiar dhe fitimit ose humbjes së emetuesit.]

PJESA 1 – Hyrje

DEKLARATA E EMETUESIT

Me siguri të plotë, deklarojmë se i gjithë informacioni dhe të dhënat e paraqitura në këtë raport financiar janë të sakta dhe korrekte dhe se nuk është hequr asnjë informacion apo e dhënë që do të cënonte saktësinë dhe plotësinë e informacionit,

nënshkruar nga [përfaqësuesi i autorizuar i emetuesit]
